



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05/347

Dt. 15.08.2022

Ne mbështetje të nenit 79 dhe 80 të Ligjit NR. 06/L-114 për Zyrtaret publike, nenit 8 të Ligjit të Punës 03/L- 212, dhe në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës shpall këtë:

K O N K U R S

Institucioni: Komuna e Podujevës

Titulli i vendit të punës: Punëtor/e teknik në Institucionet Parashkollore

Numri i pozitave: 2 (dy pozita)

Orari i punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Një vit me mundësi vazhdimi

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i institucionit përgjegjës

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e objektit, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara në oborr të institucionit parashkollor;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen e inventarit dhe për rregullimin e prishjeve teknike të inventarit;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranojnë pas publikimit të rezultateve).

Afati dhe mënyra e aplikimit

Data e njoftimit në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej **dt. 15.08.2022** deri me **dt.13.09.2022**, ndërsa **koha e aplikimit** është nga data **14.09.2022** deri me datën **28.09.2022**.

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për shërbime me qytetarë.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në test me shkrim.

Drejtori i DKA-së

Avni Fetahu

